



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes **ese** do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I

Martin Camaj

Nji vjet

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Përgjigje e plotë

- Është një ndjesi që shtrihet në raport me kohën që nuk ndalet. Stinë shkojnë e vinë, jeta vazhdon, por njeriu i dashur s'është më. Ndërkohë çdo stinë ia kujton. Ajo ka ikur në pranverë, në kohën e lulëzimit të gjithçkaje, ndërsa poeti ndien mall gjatë gjithë kohës. Në këtë mënyrë krijohet një kontrast midis jetës që vazhdon, stinëve dhe asaj që s'është më, po nuk ndodhet në këtë botë.

OSE

- Ka kaluar një vit nga ikja e njeriut të dashur e çdo stinë i kujton detaje të jetës së kaluar dikur me të. E ndërkohë ajo s'është më, nuk e shijon dot natyrën, bukuritë dhe gjallërinë e saj. Ndaj heroi lirik, kur shikon stinët që shkojnë e vinë, jetën që vazhdon, mungesa e saj i bëhet akoma më e madhe.

Përgjigje e pjesshme

- Stinët i kujtojnë njeriun e dashur;
- Stinët janë në lëvizje të përhershme, kurse jeta e njeriut është ndalur;
- Në vjeshtë ai fillon të ndiejë mall për njeriun e zemrës;
- Ajo s'është më, kurse jeta vazhdon;
- Natyra ndërron pas çdo stine, kurse ajo është e ngrirë nën dhe.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë shtrirjen e ndjesisë në të katër stinët.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme shtrirjen e ndjesisë në të katër stinët.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 8 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) **mjedisi:** tipik malësor, fshatar, bjeshkë.

b) **detaje:** përroi, mani n'oborr, përroi u tha, xhingalla ka britë e ka britë, mani asht pjekë, përroi nën shpi, strehët e pullazit, ujin n'oborr, në kusi, era nga bjeshka.

1 pikë Nëse përcakton mjedisin që shërben si sfond i kësaj poezie.

DHE

2 pikë Nëse gjen dy detaje tipike të tij.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një detaj të këtij mjedisi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 2 pikë**Model përgjigjeje**

a) **sinonimi:** vdiqe, ike nga kjo jetë, na le.

b) **arsyeja:** autori ka përzgjedhur këtë fjalë, sepse do të shmangë ngarkesën negative të fjalës vdiqe.

OSE

Vetë heroit e ka të pamundur të thotë që vdiq, ndaj përdor këtë eufemizëm për të krijuar një lloj ç'tendosjeje.

1 pikë Nëse gjen sinonimin e foljes shkove.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 10 2 pikë**Model përgjigjeje**

Vargjet ku ndihet dhimbja:

- Shkove në pranverë
- e ti s'e ke ndie, as pa.
- unë ndenja të dera tue mendue për ty.
- e prapova tue mendue për ty / të ngrime nën dhe.

2 pikë Nëse gjen dy nga vargjet e mësipërme ku ndihet dhimbja dhe vetmia e heroit lirik.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një varg ku ndihet dhimbja dhe vetmia e heroit lirik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Heroi lirik mund të provojë një **ndjesi faji**; ai ngrohet kurse ajo ndodhet *e ngrime nën dhe*.

OSE

- Heroi lirik mund të provojë një **ndjesi dhimbjeje fizike**, kur i përhumbar në kujtime të së shkuarës, befas djeg dorën në zjarr.

OSE

- Heroi lirik mund të provë **një ndjesi frike, trembjeje nga vdekja**, kur, duke u ngrohur pranë zjarrit, mes kujtimeve të së shkuarës, befas i shfaqet si e gjallë, ajo.

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që është duke përjetuar hero i lirik.

DHE

1 pikë Nëse argumenton arsyen e këtij përjetimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep argumente që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 12 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) **Foljet**: gjethen dhe lulojnë

b) **Fjalëformimi**: me prapashtesim

OSE

Të prejardhura

2 pikë Nëse gjen dy foljet që janë formuar nga emrat (1 pikë për secilën folje).

DHE

1 pikë Nëse gjen mënyrën e tyre të fjalëformimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Kontraste: stinët në lulëzim të plotë – ajo s'është më, *e ngrime nën dhe*, *e ti s'e ke ndie, as pa*.
 ➤ Heroi lirik pranë zjarrit – ajo e ngrirë
 ➤ Kontrastet midis stinëve: dimri- vera, vjeshta - pranvera
 ➤ Kumbullat lulojnë mbi kodër – prroni nën shpi u tha

2 pikë Nëse zbulon dy kontraste.

1 pikë Nëse zbulon vetëm një kontrast

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse kontrastet e gjetura i perifrazon ose i merr të shkëputura nga poezia.

PJESA II

Gëte

Fausti

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë
Pyetja 20	A	1 pikë

Pyetja 21 (a)

2 pikë

Model përgjigjeje

- Fausti ndihet i dërrmuar, i shqetësuar, i trishtuar, i drithëruar, ka një dhimbje pa fund.

OSE

- Fausti, i mbushur me dhimbje dhe trishtim të jashtëzakonshëm, përfytyron si mund të jetë ajo.

- ***Ai ngurron***, stepet ta takojë, pasi e di se ai është fajtor për gjendjen në të cilën ajo ndodhet.

OSE

- ***Fausti ka frikë*** nga përballja me të. Thellë në veten e tij ai e ndjen se kanë shkuar shumë larg, kanë shkaktuar shumë vuajtje dhe tragjedi me dashurinë e tyre.

1 pikë Nëse tregon ndjenjat që provon Fausti para takimit me Margaritën (një ndjenjë ose disa).

1 pikë Nëse shpjegon pse ai ngurron ta takojë atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b)

1 pikë

Model përgjigjeje

- Në këto vargje Gëte është duke aluduar për skenën e famshme nga tragjedia “Makbeth”, ku Zonja Makbeth, fajtohet, duke ecur si somnambul, imagjinoi gjakun e Dunkanit në duart e saj.

OSE

- Tragjedinë “Makbeth”, gjakun në duart e Zonjës Makbeth.

OSE

- Tragjedinë “Makbeth”.

OSE

- Shekspirin me veprën e tij.

1 pikë Nëse tregon skenën që të kujtojnë vargjet e dhëna..

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Margarita në këtë çast kalon në fazë çmendurie. Përfytyrimi i plotë i imazhit të fëmijës duke u mbytur, tregon për mbresat e thella që i ka lënë kjo ngjarje tragjike, ku ajo është plotësisht fajtoare.

OSE

- Në gjendje delirante, e turbulluar, në prag çmendurie të plotë, ajo i kërkon Faustit t'i shpëtojë foshnjën, e cila ka kohë që ka vdekur. Pra Margarita në këtë moment ka një shkëputje të plotë nga realiteti dhe jeton në të shkuarën e saj, e rrethuar nga një ndjesi e plotë faji.
- **Fjala** që mbart gjithë peshën e dramës së saj është foshnja (**foshnjëzën**)

1 pikë Nëse përshkruan gjendjen mendore në të cilën ndodhet Margarita.

1 pikë Nëse zbulon fjalën që mbart peshën e dramës së saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Porosia për varret e të afërmeve të saj tregon se ajo vuan që u bë shkaktoare për vdekjen e tyre. Ajo kërkon të varroset disi **veçan** si fajtoare, si njeri jo i denjë, për të qenë me ta, pasi u ka shkaktuar vdekjen.

OSE

- Ajo s'e meriton të jetë me ta, në të njëjtin varr.
- **Jo larg tyre**, pasi i do, janë njerëzit e saj. Dashuria për ta ka qenë e pastër dhe nuk do ta duronte të ishte shumë larg tyre.

1 pikë Nëse tregon pse Margarita e ndien se duhet të "varroset" pak **mënjatë**.

DHE

1 pikë Nëse tregon pse nuk duhet të "varroset" **jo shumë larg tyre**.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Ajo e di se nuk mund t'i shpëtojë dënimit për krimet që ka bërë.
- E ngarkuar me ndjesinë e fajit, se ka shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo vdekjen e të afërmeve të saj, ajo e di se s'do të ketë kurrë paqe përveçse në varr.

2 pikë Nëse tregon dy arsye pse Margarita heq dorë nga dëshira për të jetuar.

OSE

1 pikë Nëse tregon vetëm një arsye pse Margarita heq dorë nga dëshira për të jetuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 4 pikë

Model përgjigjeje

- a) **Detaji:** mënyra e ekzekutimit (*hanxharit që pret qafën time*), shpata (*Ngule shpatën në mill*), qelia e burgut (*kthinë të errët me lagështi / lëngon ajo*), emri Henrik (emër mbretërisht nga mesjeta).
- b) **Funksioni i përsëritjes** është të theksojë çastin e ekzekutimit. Është dita e fundit e jetës së saj, kur duhej të ishte dita e dasmës. Margarita ndodhet në *muzg* të jetës së saj. Kontrasti bëhet më i fortë nga kjo përsëritje: dita e fundit – dita e dasmës. Theksohet nata e saj.
- c) Fausti shprehet shkurt pasi ai është shumë më racional se Margarita, ai e ka qëllimin e qartë, i duhet të veprojë shpejt dhe pa shumë fjalë. Margarita flet shumë, pasi edhe gjendja e saj mendore nuk është shumë e kthjellët, në kundërshtim me Faustin, i cili është shumë më i fortë mendërisht dhe fizikisht.

OSE

- Për Faustin e kaluara është mbyllur (*Ç'u bë, u bë! Harro të shkuarën!*). Fausti shikon përpara, kurse Margarita jeton në të shkuarën, me dhimbjen e saj dhe ka nevojë ta shprehë atë, ta shkarkojë diku.
- Kjo tregon se ai është shumë i qartë dhe i kthjellët. Është në natyrën e meshkujve të flasin më pak dhe të veprojnë më shumë.

1 pikë Nëse tregon një detaj (nga të mësipërmet) që tregon lidhjen e veprës me sfondin mesjetar.

1 pikë Nëse tregon funksionin e përsëritjes se fjalës “dita”.

1 pikë Nëse tregon pse Fausti shprehet kaq shkurt.

DHE

1 pikë Nëse evidenton natyrën racionale të Faustit, kthjelltësinë e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton ndikimin e pakthyesëm që kanë sjelljet dhe pasionet ekstreme në jetën e njeriut.
- përshkruan ç'janë pasionet ekstreme dhe shtjellon pasojat e tyre në jetën e njeriut.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.